

Procedura  
për pranim  
në shtetësi  
të personave  
pa shtetësi

Наслов на оригиналот: Постапка за прием во државјанство за лица без државјанство

Наслов на преводот од македонски на албански: Procedura për pranim në shtetësi të personave pa shtetësi

Autor: Aleksandra Efremova

Redaktor: Zoran Drangovski

Përkthyes nga gjuha maqedonase në gjuhë shqipe: Merita Banjica

Botues: Shoqata Maqedonase e Juristëve të Rinj

Dizanji grafik dhe shtypi: Poliesterday DOOEL ,Shkup

Tirazhi: 300 kopje

Formati: A6

Numri i faqeve: 20 faqe

Shkup, 2023

CIP – Каталогизација во публикација

Национална и универзитетска библиотека “Св. Климент Охридски”, Скопје

342.71:340.13(497.7)(041)

EFREMOVA, Aleksandra

Procedura për pranim në shtetësi të personave pa shtetësi / [autor Aleksandra Efremova ; përkthyes nga gjuha maqedonase në gjuhë shqipe

Merita Banjica]. – Shkup : Shoqata maqedonase e juristëve të rinj, 2023. – 18 стр. : илустр. ; 15 см

Превод на делото: Постапка за прием во државјанство за лица без државјанство

ISBN 978-608-4843-77-1

а) Државјанство – Правна постапка за прием – Македонија – Брошури

COBISS.MK-ID 60324869

Procedura për  
pranim në shtetësi  
të personave  
pa shtetësi



## Nëse je person që nuk ka shtetësi në asnjë shtet tjetër (apatrid, person pa shtetësi):

- Së pari, është e nevojshme ta rregullosh qëndrimin tënd në Republikën e Maqedonisë së Veriut në pajtueshmëri me Ligjin për të Huaj.
- Ajo rregullohet sipas procedurës për rregullimin e qëndrimit, që bëhet nga Ministria për Punë të Jashtme. Konkretisht, ju nevojitet Departamenti për të Huaj, për personat që jetojnë në Shkup, në ndërtesën e TVM në katin e nëntë (9).
- Deri sa të pranohesh në shtetësinë e Maqedonisë, ju jeni të obliguar ta rregulloni qëndrimin tuaj në afatin e përcaktuar në lejen e qëndrimit për të huaj. Kjo do të thotë çdo tejkalimi i afatit të përcaktuar ndikon negativisht arritjen e kushtit të fitimit të mundësisë për parashtrim të kërkesës për shtetësi.

## Procedura për pranim në shtetësi

Si person pa shtetësi (apatrid), në pajtueshmëri me Ligjin për Shtetësi të Republikës së Maqedonisë së Veriut mund të filloni një procedurë për pranim në shtetësi në pajtueshmëri me dispozitat në vijim:

- **Neni 4:**

Nëse njëri nga prindërit e tu është shtetas i Maqedonisë.

- **Neni 9:**

Nëse jeni i/e martuar, i/e kurorëzuar me shtetas maqedonas. Në këtë rast kërkesën për pranim në shtetësi mund ta parashtroni pasi të kalojnë më së paku tri vite nga dita e kurorëzimit dhe nëse keni qëndrim të rregulluar më së paku një vit, në fakt pas lejimit së lejës së qëndrimit të dytë.

- **Neni 7a:**

Nëse je person pa shtetësi nga Maqedonia, i cili ka banuar vazhdimisht në Republikën e Maqedonisë së Veriut, më së paku gjashtë vite. Kjo do të thotë se ju e keni rregulluar qëndrimin tuaj si i/e huaj pa ndërprerje për gjashtë vite dhe ju është lëshuar leje qëndrimi e përkohshme për një të huaj ose keni një leje qëndrimi të përhershme për një të huaj ose keni një leje qëndrimi të përhershme për një të huaj.

## *Procedura për vërtetimin e shtetësisë sipas origjinës (Neni 4 i Ligjit për Shtetësinë e RMV):*

- 1.** Nëse prindërit tuaj janë shtetas maqedonas, ty të takon shtetësia maqedonase menjëherë pas regjistrimit në regjistrin amzë së të lindurve, pa marrë parasysh vendin e lindjes (a je i/e lindur në Republikën e Maqedonisë së Veriut ose jashtë në ndonjë vend tjetër).
- 2.** Nëse je i/e lindur në territorin e Maqedonisë së Veriut dhe njëri nga prindërit e tu është shtetas maqedonas, me vet regjistrimin në regjistrin e të lindurve, ty do të vërtetohet shtetësia maqedonase.
- 3.** Nëse nuk ke shtetësi maqedonase, por babai yt është shtetas maqedonas dhe posedon dokument me të cilin është vërtetuar atësia, është e nevojshme të parashtrosh një kërkesë deri te shërbimi kompetent për regjistrimin e të lindurve te Drejtoria për Udhëheqjen e Librave Amzë - Zyra Rajonale dhe ta dorëzosh dokumentin, me të cilën vërtetohet atësia. Bazuar në atë dokument, do të regjistrohet në çertifikatën tuaj të lindjes atësia dhe do të vërtetohet shtetësia maqedonase.

- 4.** Nëse je i/e lindur në territorin e Republikës së Maqedonisë së Veriut, njëri nga prindërit është shtetas maqedonas, ndërsa tjetri i huaj, mund të regjistrohesh në shtetësinë maqedonase, nëse prindi i cili është i huaj, pajtohet të jesh i regjistruar në shtetësinë maqedonase.
- 5.** Njëri nga prindërit nëse është shtetas maqedonas, ndërsa tjetri i huaj, mund të regjistrohesh në shtetësinë maqedonase, përderisa prindi i cili është i huaj, pajtohet të jesh i regjistruar në shtetësinë maqedonase:
- Prindërit tuaj të parashtrojnë kërkesë për regjistrim në regjistrin e shtetasve deri sa ti të arrish moshën 20 vjeçe. Pasi që e ke arritur moshën 20 vjeçe personalisht mund të parashtrosh kërkesë, që të mund të regjistrohesh në regjistrin e shtetasve. Këtë kërkesë mund ta parashtrosh derisa nuk je bërë 23 vjeç.

**Kërkesa parashtarohet në  
përfaqësinë kompetente  
konsulare të Republikës së  
Maqedonisë së Veriut në vendin e  
lindjes ose në Ministrinë për Punë  
të Brendshme Rajonale në Zyrën e  
Çështjeve Administrative.**





## Dokumentet e nevojshme:

- Certifikata e lindjes për fëmijën nga regjistri amzë.
- Vërtetim të shtetësisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut për prindërit /prindit.
- Nëse fëmija është i mitur, pajtueshmëri nga prindi që është i huaj.
- Letërnjoftim i prindit-kujdestar i fëmijës.
- Autorizim i vërtetuar për pajtueshmëri (i vërtetuar në noter ose në ndonjë ambasadë/ përfaqësi konsulare) nëse kërkesa është parashtruar nga një person i autorizuar.



### **E RËNDËSISHME:**

Nëse prindi tjetër është i panjohur ose është person me shtetësi të panjohur fëmija do të fitojë shtetësinë maqedonase, pavarësisht nga vendi i lindjes.



## *Neni 7 i Ligjit për Shtetësi në RMV- Dispozitat kalimtare dhe përfundimare:*


Nëse je person pa shtetësi, dhe ke qenë shtetas/e i/e ish-Jugosllavisë dhe prej më 8 Shtator 1991 ke jetuar në Republikën e Maqedonisë dhe të paktën ke një provë (dëshmi) me të cilën mund ta vërtetosh se ke jetuar prej më 8 Shtator 1991 në Republikën e Maqedonisë, mund të parashtrosh kërkesë për pranim në shtetësinë maqedonase.

Sipas kësaj dispozite, me kërkesë për pranim në shtetësi, nevojitet të paraqeshësh më së paku një nga provat në vijim, të lëshuara nga institucionet e Republikës së Maqedonisë:

- Certifikata e lindjes nga regjistri i të lindurve
- Certifikatë, vërtetim ose diplomë si dëshmi për vitin shkollor të përfunduar.
- Dëshmi të punësimit (formularët M1/M/2 ose librezë të punës).
- Librezë shëndetësore
- Letërnjoftim i lëshuar nga RFS e Jugosllavisë ose nga Republika e Maqedonisë.
- Pasaporta e lëshuar nga RFS e Jugosllavisë ose nga Republika e Maqedonisë.
- Dëshmia e tatimit të paguar si tatimi mbi pronën dhe të drejtat pronësore, tatim mbi të ardhurat

ose tatim mbi trashigiminë dhe dhuratën.

- Dëshmi për fatura të pagura më parë për shërbimet në vijim:
  - Energji elektrike
  - Ujësjiellës
  - Ngrohje
  - Shërbimet telefonike;
- Fletë pronësie në emër të kërkuesit të shtetësisë.
- Libreze të kursimit.
- Dëshmi të tjera të lëshuara nga institucione kompetente.
- Kërkesa për shtetësi dorëzohet personalisht në zyrat e MBP-së. Kërkesës i bashkangjiten edhe tri kopje nga dëshmitë e lartëpërmendura. Njëra nga dëshmitë, do të thotë kopja të jetë e noterizuar në bazë të origjinalit. Noterizimi kushton 150 denarë.
- Gjatë dorëzimit të kërkesës, nevojitet të paguash taksë administrative në vlerë 20 euro, në kundërvlerë të denarit (përafërsisht 1234 denarë, por shuma varet nga kursit i këmbimit të euros në ditën e pagesës).
- Shuma mund të paguhet në bankë ose përmes postës ose në vet sportelin ku e dorëzoni kërkesën, por me kartelë bankare debitore ose kreditore.

- Gjatë dorëzimit të kërkesës, me vete duhet të paraqesish dokument të identifikimit-letërnjoftim, pasaportë ose leje të qëndrimit për të huaj. Nëse nuk ke dokument të tillë, e nevojshme është të parashtrosh një deklaratë të notarizuar nga dy dëshmitarë që e vërtetojnë identitetin tënd.
  - Biografi të shkurtër.
  - Gjatë marrjes së vendimit për pranim në shtetësi, nevojitet të paguash 80 euro në kundërvlerë të denarit (përafërsisht 4940 denarë, por shuma varet nga nga kursi i këmbimit të euros në ditën e pagesës). Shuma mund të paguhet në vet sportelin, por vetëm me kartelë bankare debitore ose kreditore.
- 



### **E RËNDËSISHME:**

Kjo dispozitë ligjore do të zbatohet me vlefshmëri të kufizuar, domethënë deri më 8 gusht 2024.

Kjo do të thotë se ju mund të aplikoni kërkesë për pranim në shtetësi mbi këtë bazë jo më vonë se 8 gusht 2024.



## *Marrja e shtetësisë në bazë të natyralizimit*

Nëse je person pa shtetësi dhe ligjërisht dhe pandërprerë banon në Republikën e Maqedonisë së Veriut, më së paku gjashtë vite, ke mundësi të marrësh shtetësi maqedonse nëse i kushtet në vijim:

- Të kesh mbushur përafërsisht 18 vite.
- Të banosh në mënyrë të ligjshme të përhershme në territorin e Republikës së Maqedonisë së Veriut, më së paku gjashtë vite.
- Të kesh siguruar banesë dhe burim të përhershëm të të ardhurave (parave).
- Të mos jesh i/e dënuar me burgim së paku me kohëzgjatje një vit për vepra për të cilat ndiqet sipas detyrës zyrtare.
- Të mos zhvillohet asnjë procedurë penale kundër teje në Republikën e Maqedonisë së Veriut.
- Ta zotërosh gjuhën maqedonase dhe lehtësisht të mund të komunikosh me të tjerët në mjedisin ku vepron.
- Kundër teje të mos jetë e shqiptuar asnjë masë ndalese për qëndrim në Republikën e Maqedonisë së Veriut.
- Pranimi yt në shtetësi të mos e rrezikojë sigurinë dhe mbrojtjen e Republikës së Maqedonisë së Veriut;

## *Cilat dokumente të nevojiten për fillimin e procedurës për pranim në shtetësinë maqedonase?*

- Certifikata e lindjes nga libri amzë (kopje ose origjinal).
- Biografi të shkurtër me të gjithë të dhënat personale të tua dhe të prindërve të tu (data dhe vendi i lindjes, në cilën shkollë ke ndjekur mësimin, ku banon, emri dhe mbiemri i prindërve të tu, a kanë prindërit e tu shtetësi maqedonase, ku jetojnë dhe të ngjajshme).
- Dokument identifikimi (Leja e qëndrimit të një të huaji).
- Dëshmi për banesë të siguruar (fleta e pronësisë brishenje ose kontratë qiraje ose vendim për pagimin e tatimit përderisa objekti nuk është i legalizuar).
- Dëshmi se ke siguruar burim të përhershëm të ardhurave (dëshmi të marrëdhënies së punës ose se ke burim tjetër të të ardhurave si p.sh, ndihmë sociale me të holla ku është e shënuar shuma e të hollave që i pranon.).



## **E RËNDËSISHME:**

Gjatë fillimit të procedurës është e nevojshme të paguhet tarifa (taksa) administrative në shumë prej 20 euro në kundërvlerë të denarit (përafërsisht 1234 denarë, shuma varet nga kursi i euros në ditën e pagesës). Shumën mund ta paguani edhe në sportelin e MPB gjatë dorëzimit të kërkesës, por vetëm me kartelë bankare debitore ose kreditore.

Gjatë ngritjes së vendimit për pranim në shtetësisë është e nevojshme të paguani 80 euro në kundërvlerë të denarit (përafërsisht 4940 denarë, shuma varet nga kursi i euros në ditën e pagesës).

Deri në marrjen e shtetësisë maqedonase, ke obligim rregullisht ta rregullosh qëndrimin tënd si huaj.





## *Procedura për pranim në shtetësi në bazë të martesës me shtetas maqedonas:*

Nëse je person pa shtetësi dhe je i/e martuar me shtetas maqedonas, mund të parashtrosh kërkesë për pranim në shtetësi nëse i plotëson kushtet në vijim:

- A kanë kaluar më pak se tre vite nga kurorëzimi juaj dhe kur brishenje keni dorëzuar kërkesën për shtetësi, a ka kaluar më së paku një vit ligjërishit dhe keni pasur qëndrim të pandërprerë në Republikën e Maqedonisë së Veriut.

Dokumentet e nevojshme që duhet të dorëzohen krahas aplikimit për pranim në shtetësinë e Republikës së Maqedonisë së Veriut:

- Biografi të shkurtër
- Certifikata e kurorëzimit të çiftit të martuar.
- Kopje nga leja e qëndrimit për të huaj.
- Kopje të letërnjoftimit të bashkëshortit /es nëse është shtetas/e i/e Republikës së Maqedonisë së Veriut.



### **E RËNDËSISHME:**

Nëse bashkëshorti/ja juaj është shfrytëzues i ndihmës minimale të garantuar, ke të drejtë të jesh i/e liruar nga detyrimi për të bërë pagesën e tarifave (taksave) administrative në procedurën për pranim në shtetësi.



Për atë qëllim, e nevojshme është bashkë me kërkesën për pranim në shtetësi, të parashtroni edhe një kërkesë për lirim nga shpenzimet dhe krahas kërkesës të paraqisni dëshmi një vërtetim të lëshuar nga Qendra për Punë Sociale sipas vendit të vendbanimit tënd, që konfirmon se bashkëshorti/ja juaj është përdorues i ndihmës sociale dhe tregon se çfarë shume pranon.



Nëse të nevojitet ndihmë juridike falas për procedurën për pranim në shtetësi ose nëse ke paqartësi lidhur me broshurën, na u drejtoni në kontakt adresat dhe numrat e telefonave në vijim:

## SHOQATA MAQEDONASE E JURISTËVE TË RINJ

Rr: Donbas Nr. 14/6 1000 Shkup  
(Debar Maallo, ndërtesa Nastel, pas Vardar Mebel)

Telefoni **02 3220 870** dhe  
Rr/Brigada Kosovare Maqedonase nr. 17/2  
(Shuto Orizari, përballë Marketit Kiper)

Telefoni: **02 2655 844**

 [www.myla.org.mk](http://www.myla.org.mk)

 [contact@myla.org.mk](mailto:contact@myla.org.mk)

 [younglawyersmacedonia](https://www.facebook.com/younglawyersmacedonia)

 [myla\\_mzmp](https://www.instagram.com/myla_mzmp)



**M3MP**

